



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 505/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Kamenicë paraqitur kundër Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Kamenicë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Kamenicë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Kamenicë, në të cilën ka theksuar se me dt 03 Nëntor rreth orës 14.15, në Vendvotimin 1026D/03D komuna Kamenicë, kandidatja e subjektit politik PDK për kuvend komunal Donjeta Morina ka qëndruar për kohë të gjatë në këtë vendvotim, duke bërë presion në votuesit. Më tutje ka pretenduar se ky veprim është në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 par. 1 pikës a) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së, duke pasur parasysh se qëndrimi i kandidatëve të subjektit politik është i ndaluar ditën e zgjedhjeve, me përjashtim të ushtrimit të drejtës në votim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LQP-së, parashihet se: *“Mund të apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 505/2013 më datën 07.11.2013


Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

***Këshillë Juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*